



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 10931 prot.

Shkodër, më 30.5. 2025

**VENDIM**

**Nr. 29, datë 29.05.2025**

**“PËR DHËNIEN E TË DREJTËS DHE CAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË  
MENAXHIMIT, ADMINISTRIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PLAZHEVE PUBLIKE  
TË MENAXHUESHME PËR SHOQËRINË AKSIONERE NË PRONËSI TË BASHKISË  
SHKODËR ME NIPT M36924003O”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.05.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 139, datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar; VKM-së Nr.649, datë 16.10.2024 “Për Miratimin e Rregullores për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”, neni 4; VKB-së nr. 15, datë 20.7.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare Bio Strajca sh.a, si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

**VENDOSI:**

1. Të miratohet dhënia e së drejtës dhe caktimi i përgjegjësisë për menaxhimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e plazheve publike të menaxhueshme, sipas VKM-së nr. 649, datë 16.10.2024, shoqërisë aksionare me NIPT M36924003O.
2. Afati për të cilin i jepet e drejta dhe i caktohet kjo përgjegjësi do të jetë 5 (pesë) vjet, sipas hartës së përditësuar ndër vite.
3. Shoqëria aksionare me NIPT M36924003O do ta ushtrojë këtë veprimtari sipas kriterëve dhe përcaktimeve ligjore në fuqi.
4. Shoqëria aksionare me NIPT M36924003O nuk ka të drejtë t’ia japë këtë hapësirë me qira palëve të treta apo ta shfrytëzojë bashkërisht me operatorë të tjerë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 28 vota

|                  |            |
|------------------|------------|
| Vota Pro         | 28         |
| Vota Kundër      | 13         |
| Vota Abstenim    | 0          |
| Zbardhur me datë | 30.05.2025 |

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**



**KRYETAR**

**Oltion LULI**

